



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:016314

Datë: 06.03.2025

Numri i dokumentit: 06949356

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.65/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekaliu, me zyrtaren ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit F.K nga fshati ..., Komuna Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Nexhat Beqiri me seli të zyrës në Vushtrri, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.I.nr.375/22 të datës 02.02.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 05.03.2025, në praninë e Prokurorit së Shtetit Rilinda Kadriu, të pandehurit F.K, mbrojtësit av. Nexhat Beqiri, në të njëjtën datë shpalli, dhe me datë 05.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. I pandehuri : F.K, nga i ati R..., e ëma N..., e vajzërisë H..., i lindur më ..., në fshatin ..., Komuna Mitrovicë, me numër personal ..., të kryer shkollën e mesme, teknik i makinerisë, pensionist, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

SHPALLET FAJTOR

I. SEPSE: prej datës dhe vitit të pacaktuar e deri me datë 15.09.2022 rreth orës 15:00, në Vushtrri, më saktësisht në shtëpinë e të pandehurit F.K, pa leje përkatëse, e në kundërshtim me ligjin për armët, ka mbajtur në posedim armën e zjarrit- pistoletën e markës “Ecol Special 99”, cal 9mm,

P.A.K, me nr. serik U-111205000, karikatorin si dhe 25 fishek, pra të gjitha këto i pandehuri i ka mbajtur pa autorizim e të cilat janë sekuestruar nga zyrtarët policor,

Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 36, 39, 64, 65, 66 dhe 67 të KPK-së, si dhe nenit 241, 242, 362, 249, 276 dhe 450 të KPPK-së, e

E G J Y K O N

I. ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese prej dy (2) vite.

II. KONFISKOHET nga i pandehuri F.K, arma “Ecol Special”, e kalibrit 9mm, me numër serik U-11120500.

III. DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.I.nr.375/22 e datës 02.02.2023 kundër të pandehurit F.K nga fshati ..., Komuna Mitrovicë, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 05.03.2025, në të cilën seancë ka prezantuar Prokurori i Shtetit Rilinda Kadriu, i pandehuri F.K së bashku me mbrojtësin e tij av. Nexhat Beqiri.

Pas leximit të aktakuzës, nga ana e Prokurorit të Shtetit, dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe sqarimit të benefiteve dhe pasojave të pranimit të fajësisë, të njëjtit i është ofruar mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë. I pandehuri F.K ka deklaruar se ndjehet fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, është penduar për veprën, i ka premtuar gjykatës së në të ardhmen nuk do ta përsëris vepra penale të kësaj natyre apo natyrave të tjera.

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë dhe meqë i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është vullnetar në konsultim me mbrojtësin e tij, po ashtu i bazuar në faktet e çështjes që përmban aktakuza, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit dhe me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, me të cilat do të arrihet qëllimi i dënimit.

Avokati mbrojtës lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare, në pajtim me dispozitat ligjore të cilat parashohin pranimin e fajësisë dhe se të njëjtit i është shpjeguar në detaje instituti i pranimit të fajësisë dhe këtë pranim të fajësisë e ka bërë pa kurrfarë imponimi apo presioni. Ka shtuar se i mbrojturi i tij është i shtyrë në moshë, gjatë jetës së tij nuk ka kryer asnjëherë vepër penale, jeton në kushte mjaft të rënda, ka një fëmijë të sëmurë me sindromën doën, andaj gjykatës i ka propozuar që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit të shqiptojë një dënim sa më të butë me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit, po ashtu gjykatës i ka propozuar që ta pranojë pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Faktet e çështjes në raport me provat që përmban aktakuza.

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: kallëzimi penal me numër 2022-BD-864 i datës 19.09.2022,

raporti policor i datës 16.09.2022, procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit, i datës 17.01.2023, vërtetimi mbi konfiskimin e armës, i datës 16.09.2022, fotodokumentacioni i datës 19.09.2022 si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysht vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana rënduese për të pandehurin ka gjetur, shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit shoqëror që paraqet kjo veprë penale, ndërsa në kuadër të rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin e tij për kryerjen e kësaj veprë penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë vepra penale, më parë i pa gjykuar dhe faktin se i pandehuri ka gjendje të rëndë ekonomike.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se, edhe me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bien në kundërshtim me ligjin, t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

Vendimin lidhur me konfiskimin e armës, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 269 par.1 e në lidhje me nenin 276 KPPK-së, pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari nuk posedonte leje për mbajtjen e armës, dhe rrjedhimisht sendet e tilla i nënshtrohen automatikisht konfiskimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 dhe nenit 450 par. 1 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.65/2023, datë 05.03.2025

Zyrtarja Ligjore

Arta Jusufi

Gj y q t a r i

Naim Rekaliu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.